



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 46 datë 30.10.2020

**PËR NDRYSHIMIN E NJË PJESE TË SEGMENTIT RRUGORË NË OBLIKË,
NGA RRUGA “KREBAJ” NË RRUGA “ADMIR BOKRINA” SIKURSE
PËRCAKTOHET NË HARTËN TREGUESE BASHKËNGJITUR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 30.10.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1, nën-pika 1.7 shkronja “b”, nenin 54 shkronja “ll”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 3 të ligjit nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, shkresës nr. 1391/1 datë 28.3.2019 të Ministrit të Brendshëm “Plani i masave mbi finalizimin e procesit të emërtimeve të qyteteve, bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve në Republikën e Shqipërisë dhe paisjen me adresë të shtetasve shqiptarë”, pas shqyrtimit të Relacionit “Për emërtimin e rrugës së varrezave të Oblikës, sikurse përcaktohet në hartën treguese bashkëngjitur, Rruga “ADMIR BOKRINA”, me 41 vota Pro,

V E N D O S I:

1. Miratimin për ndryshimin e një pjese të segmentit rrugorë në Oblikë, nga rruga “Krebaj” në rruga “Admir Bokrina” sikurse përcaktohet në hartën treguese bashkëngjitur
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit


Denis Lezha

